

TERMAT E REFERENCËS**PËR PËRZGJEDHJEN E DY KOORDINATORËVE PËR MENTORIMIN DHE MBËSHTETJEN E SHKOLLAVE**

Organizata kontraktuese	Qendra për Aftësi Konkurruese (CCS)
Marrëveshja	Marrëveshja e Kontributit të Bashkimit Evropian nr. AL/IPA III/IPA2022/02
Pozicioni	Koordinator për Mentorimin dhe Mbështetjen e Shkollave
Numri i pozicioneve	2 (dy)
Vendi i punës	Tiranë, me udhëtime të rregullta në bashkitë dhe shkollat e përfshira në projekt
Periudha e parashikuar	Nga data e përcaktuar në kontratën individuale deri më 9 tetor 2027
Raportimi	Pranë ekipit drejtues të projektit dhe Drejtores Ekzekutive të CCS-së

1. Konteksti

Qendra për Aftësi Konkurruese, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Kontributit të Bashkimit Evropian nr. AL/IPA III/IPA2022/02, do të përzgjedhë dy Koordinatorë për Mentorimin dhe Mbështetjen e Shkollave. Pozicionet synojnë të sigurojnë koordinimin, ndjekjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të aktiviteteve të projektit në nivel vendor, si dhe lidhjen funksionale ndërmjet ekipit qendror të projektit, shkollave, mësuesve, mentorëve, strukturave vendore të arsimit, komuniteteve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë.

2. Qëllimi i pozicionit

Koordinatori për Mentorimin dhe Mbështetjen e Shkollave do të mbështesë planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve në shkollat dhe territorin e caktuar, do të monitorojë cilësinë e zbatimit, do të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për mësuesit dhe mentorët dhe do të sigurojë përcjelljen e rregullt të informacionit, rezultateve, problematikave dhe nevojave për mbështetje të ekipi drejtues i projektit.

3. Mbulimi territorial dhe organizimi i punës

Secili Koordinator do të mbulojë një grup të përcaktuar shkollash pilot. Njëri Koordinator do të mbulojë kryesisht bashkitë dhe shkollat e grupuara në zonën veriore, ndërsa Koordinatori tjetër do të mbulojë kryesisht bashkitë dhe shkollat e grupuara në zonën jugore.

Shkollat e parashikuara për t'u përfshirë në projekt ndodhen në bashkitë: **Skrapar, Dibër, Librazhd, Prrerjas, Divjakë, Gjirokastrë, Pogradec, Kukës, Kurbin, Lezhë, Vorë dhe Sarandë.**

Ndarja përfundimtare territoriale do të përcaktohet nga CCS-ja duke marrë në konsideratë numrin dhe shpërndarjen e shkollave, numrin e mësuesve të përfshirë, ngarkesën e punës dhe nevojat operative të projektit. CCS-ja ruan të drejtën të rishikojë ndarjen territoriale gjatë zbatimit, kur kjo është e nevojshme për sigurimin e një mbulimi të balancuar dhe efektiv.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Hartimi dhe përditësimi i planit të detajuar të punës për grupin e shkollave dhe territorin e caktuar, në përputhje me planin e përgjithshëm të projektit.
- Përgatitja dhe përditësimi i kalendarit të aktiviteteve, trajnimeve, sesioneve të mentorimit dhe vizitave në terren.

- Koordinimi me ekipin e CCS-së, UNICEF-in, institucionet arsimore vendore, shkollat, mësuesit, mentorët dhe strukturat e tjera të përfshira.
- Mbështetja e organizimit dhe koordinimit logjistik të trajnimeve, workshop-eve, sesioneve të mentorimit, vizitave monitoruese dhe aktiviteteve të tjera.
- Ofrimi i mbështetjes dhe mentorimit të vazhdueshëm për mësuesit dhe edukatorët që zbatojnë modulet dhe aktivitetet e projektit.
- Monitorimi i ecursisë dhe cilësisë së zbatimit të aktiviteteve në shkollat e caktuara dhe ofrimi i mbështetjes teknike dhe organizative.
- Mbështetja e shkollave në organizimin e aktiviteteve me nxënësit, mësuesit, prindërit, komunitetet dhe përfaqësuesit e sektorit privat.
- Koordinimi dhe lehtësimi i shkëmbimeve të eksperiencave dhe aktiviteteve të të nxënit mes kolegëve ndërmjet shkollave.
- Mbledhja, verifikimi dhe sistemimi i të dhënave, listëprezencave, formularëve të monitorimit dhe dokumentacionit tjetër mbështetës.
- Sigurimi i komunikimit dhe mekanizmave të rregullt të raportimit dhe feedback-ut ndërmjet shkollave, CCS-së dhe ekipit drejtues të projektit.
- Përgatitja e raporteve periodike mbi progresin, problematikat, rezultatet dhe rekomandimet për shkollat dhe zonat e mbuluara.
- Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me zyrat vendore të arsimit, shkollat, komunitetet, bizneset dhe aktorët e tjerë vendorë.
- Identifikimi dhe dokumentimi i historive të suksesit, fotografive, praktikave të mira dhe mësimave të nxjerra dhe përcjellja e tyre te personi përgjegjës për komunikimin.
- Identifikimi në kohë i vonësive, risqeve ose vështirësive të zbatimit dhe propozimi i masave korrigjuese.
- Pjesëmarrja në takimet e koordinimit, planifikimit, monitorimit dhe raportimit të organizuara nga CCS-ja dhe UNICEF-i.
- Respektimi i kërkesave të projektit për mbrojtjen e fëmijëve, mosdiskriminimin, konfidencialitetin, komunikimin dhe dukshmërinë.
- Kryerja e detyrave të tjera të lidhura drejtpërdrejt me funksionin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të projektit.

5. Kriteret minimale të kualifikimit

- Diplomë universitare, të paktën në nivelin Bachelor, në shkenca sociale, edukim, menaxhim, administrim publik, ekonomi, komunikim, zhvillim komunitar ose fusha të tjera të ngjashme.
- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale relevante.
- Eksperiencë në koordinimin ose zbatimin e projekteve në fushën e arsimit, aftësive për jetën, orientimit për karrierën, zhvillimit të të rinjve, përfshirjes sociale ose zhvillimit komunitar.
- Eksperiencë në bashkëpunimin me shkolla, mësues, institucione publike, organizata jofitimprurëse ose komunitete vendore.
- Aftësi të mira organizative, planifikuese dhe koordinuese.
- Aftësi për të përgatitur plane pune, raporte, procesverbale dhe dokumentacion monitorimi.
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me aktorë të niveleve të ndryshme.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe në komunikim dhe shkrim dhe njohuri të mira të gjuhës angleze.
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office dhe mjeteve të komunikimit dhe bashkëpunimit online.
- Gatishmëri për udhëtime të rregullta në bashkitë dhe shkollat e projektit.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip, për të menaxhuar disa detyra njëkohësisht dhe për të respektuar afatet.
- Integritet profesional, paanshmëri dhe përkushtim ndaj parimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe mosdiskriminimit.

Do të konsiderohen avantazh: eksperiencia e mëparshme në mentorimin e mësuesve, koordinimin e trajnimeve, monitorimin e aktiviteteve në shkolla ose zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, UNICEF-i apo donatorë të tjerë.

6. Periudha dhe kushtet e angazhimit

Angazhimi do të fillojë në datën e përcaktuar në kontratën individuale dhe do të vijojë deri më 9 tetor 2027, brenda periudhës së zbatimit të projektit. Data e fillimit, kohëzgjatja konkrete dhe kushtet e kontraktimit për secilin kandidat të përzgjedhur do të përcaktohen në varësi të nevojave operative, planit të zbatimit dhe disponueshmërisë së fondeve.

Pozicioni do të jetë i vendosur pranë zyrës së CCS-së në Tiranë dhe kërkon udhëtime të rregullta në bashkitë dhe shkollat e përfshira në projekt. Kostot dhe kushtet e udhëtimeve do të trajtohen sipas rregullave dhe procedurave të zbatueshme të projektit dhe CCS-së.

7. Dokumentacioni i aplikimit

- CV e përditësuar;
- Letër motivimi;
- Dokumente mbështetëse që dëshmojnë kualifikimet dhe eksperiencën profesionale, sipas rastit.

Kandidatët mund të paraqesin në letrën e motivimit preferencën e tyre për mbulimin e grupit verior ose jugor. Preferenca e shprehur nuk përbën garanci për caktimin përfundimtar territorial.

8. Mënyra dhe afati i aplikimit

Aplikimet duhet të dërgohen jo më vonë se **27 korrik 2026, ora 17:00**, në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- Me e-mail në adresën info@competitiveskills.org, me subjekt: “Aplikim – Koordinator për Mentorimin dhe Mbështetjen e Shkollave”;
- Fizikisht në adresën: Qendra për Aftësi Konkurruese, Rruga “Shyqyri Bërxolli”, Pallati Aurora, Kati 7, Ap. 28, Tiranë, Shqipëri.

Aplikimet e paraqitura pas përfundimit të afatit mund të mos merren në konsideratë. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për intervistë. CCS-ja ruan të drejtën të zgjasë afatin e aplikimit nëse nuk sigurohet një numër i mjaftueshëm kandidatësh të kualifikuar.

9. Procedura dhe kriteret e vlerësimit

Procedura është e hapur për kandidatë të brendshëm (punonjës aktual të CCS) dhe të jashtëm. Kandidatët do të vlerësohen në mënyrë të barabartë, transparente dhe konkurruese. Punësimi ose angazhimi i mëparshëm apo aktual pranë CCS-së nuk garanton përzgjedhjen dhe nuk sjell pikë shtesë, përveç rasteve kur eksperiencia konkrete e kandidatit përputhet me kriteret profesionale të përcaktuara në tabelën e vlerësimit. Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e dokumentacionit të aplikimit dhe intervistës, me një total prej 100 pikësh.

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët
A	Vlerësimi i CV-së dhe dokumentacionit	70
1	Arsimi dhe kualifikimet akademike relevante	10
2	Eksperiencia në koordinimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e arsimit, zhvillimit të të rinjve, përfshirjes sociale ose zhvillimit komunitar	20
3	Eksperiencia në punën me shkolla, mësues, mentorë, institucione publike dhe komunitete vendore	15

Nr.	Kriteri i vlerësimit	Pikët
4	Eksperienca në mentorim, organizim trajnimesh, aktivitete shkollore ose procese të të nxënësve mes kolegëve	10
5	Eksperienca në monitorim, mbledhje të dhënash, dokumentim dhe raportim	10
6	Njohuritë e gjuhës angleze dhe përdorimi i Microsoft Office dhe mjeteve online	5
B	Intervista	30
7	Kuptimi i rolit, detyrave dhe qasjes së mentorimit dhe mbështetjes së shkollave	10
8	Aftësitë organizative, analitike dhe për zgjidhjen e problemeve praktike	10
9	Aftësitë e komunikimit, bashkëpunimit, disponueshmëria dhe gatishmëria për udhëtime	10
	TOTALI	100

Për t'u konsideruar për përzgjedhje, kandidati duhet të marrë të paktën 60 pikë nga 100 pikë. Dy kandidatët me pikët më të larta do të rekomandohen për kontraktim, me kusht që të plotësojnë pragun minimal dhe kërkesat e tjera të procedurës.

Në rast barazimi pikësh, përparësi do të ketë kandidati që ka marrë më shumë pikë në kriteret që lidhen me koordinimin dhe zbatimin e projekteve, punën me shkollë dhe mësues, si dhe rezultatin e intervistës.

11. Dispozita të përgjithshme

- Zhvillimi i procedurës së përzgjedhjes nuk krijon detyrim automatik për lidhjen e kontratës.
- CCS-ja garanton trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të kandidatëve gjatë gjithë procedurës.
- Kandidatët duhet të deklarojnë çdo konflikt real, potencial ose të perceptuar interesi që mund të ndikojë në ushtrimin e detyrës.
- Të dhënat personale dhe dokumentacioni i aplikantëve do të përdoren vetëm për qëllimet e procedurës së përzgjedhjes dhe do të trajtohen në përputhje me kërkesat për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Miraturuar me Urdhrin "Për miratimin e termave të referencës dhe caktimin e personit përgjegjës për ndjekjen e procedurës me objekt "koordinator për mentorimin dhe mbështetjen e shkollave"', datë 20.07.2026, të Drejtoreshës Ekzekutive të Qendrës për Aftësi Konkurruese.